



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi \_ dhe neni 23 të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë „, numër 12 / 2019 ) nenit 40 dhe 41 të Rregullores për punë të Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit, duke vepruar sipas raportit për denoncim të korrupsionit të parashtruar nga ish kryetari i sindikatës së SHA ..... nga ..... Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 42-të e mbajtur me datë 11.12.2020 miratoi

### VENDIM

Denoncimi për korrupsion me nr. 12-5579/1 i datës 10.12.2019, është parashtruar nga ish kryetari i sindikatës së SHA ..... nga ..... **REFUZOHE**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit nuk ka elemente që me kompetencat e saj të veproj në lëndën me numër 12 - 5579 të vitit 2019 e formuar në bazë të kërkesës me nr. 12/5579/1 të datës 10.12.2019, procedura për lëndën e falimentimit akoma është në rrjedhë tek organet adekuate të autorizuar të RMV-së.

Lënda me numër 12-4562 nga viti 2019 të mbyllët dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dërgohet Vendimi i KSHPK-së, me sqarim.

Vendimi i Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit, me sqarim të depersonalizuar të publikohet në web faqen e Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit me afat prej 5 (pesë) ditësh nga sjellja e vendimit.

### Sqarim

Lënda me numër 12-5579 nga viti 2019 e formuar në bazë të denoncimit 12-5579/1 të datës 10.12.2019, e parashtruar para Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) ,nga ish kryetari i sindikatës SHA ..... nga .....

Në denoncim paraqiten akuza për dyshimë për kryerje të falimentimit mbi SHA ..... nga ....., e cila ishte e dërguar në falimentim në kundërshtimë me rregulloren ligjore, në kohën në të cilën llogaria e tijë bankare akoma ishte aktive. Kërkohe që KSHPK të verifikohet procedura e lëndës së falimentimit.

Gjatë shqyrtimit të përmbajtje së denoncimit, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) i merrë parasysh pretendimet e denoncuesit dhe në bazë të së cilave konstaton si në vijim:

Në rastin konkret bëhet fjalë për akuza që pretendojnë për procedurë falimentimi në SHA ..... nga ..... e cila ishte e inicuar në kundërshtim me rregulloren ligjore, dhe në kohën që llogaria bankare e tijë ishte akoma aktive.

Në denoncimin e parashtruar pretendohet për parregullsi të shumta në procedurën e falimentimit, ndërsa njëra prej tyre është ajo se nuk është bërë regjistrim i mjeteve themelore në qarkullim të SHA, nga ana e udhëheqësisë së Shoqërisë, në bashkpunim me menaxherin dhe magazinierin, ishte kryer bastisje në magazine dhe prej aty ishin marur të gjitha mjetet e punës dhe retromatricialet, ndërsa në këthim të tyre gjatë procedurës së falimentimit ishin paguar me kërkesë të drejtuesit dhe magazinierit, e cila edhe më shumë shërben si dëshmi kundër tyre, për këtë shkakë kërkohet verifikim i lëndës në procedurën e falimentimit dhe qëndrojnë në dispozicionë për sqarim të mëtutjeshmëm të lëndës.

-Me datë 05.01.2017 ka patur njoftim në media se me kërkesë të Drejtorisë për të ardhura publike se është hapur procedurë për falimentim të Shoqatës Aksionare ,,.....,, nga ....., për tshkakë se kjo shoqëri Drejtorisë i detyrohet për shumta të mëdha parashë, për mos pagesen e kontributeve dhe tatimeve. Në tekstin e publikuar është e theksuar se procedura e falimentimit është e hapur me datë 21 dhjetorë të vitit 2016 dhe nga ana e Gjykatës Themelore \_\_\_\_\_, ku si drejtues i falimentimit ishte shpallur personi ..... nga ..... Gjithashtu Drejtoria e të ardhurave publike edhe në vitin 2013 ka kërkuar falimentim për këtë shoqëri aksionare, e cila është hubës disavjecarë edhe në dominimin e pronësisë shtetërore.

-Me datë 05 januar të vitit 2017, në medime është njoftuar se në Regjistrin qendrorë të RM-së me vendim është pranuar propozim për mbylljen e procedurës së falimentimit ndaj të detyruarit,,.....,, që ishte parashtruar nga kreditorët e Republikës së Maqedonisë, Ministria e finansave ,DAP DR, Manastrir.

-Me datë 15 shtatorë të vitit 2017, është zhvilluar procedurë për ankand publikë në lidhje me objektin në pronësi të .....në falimentim - konkretisht OBJEKTET në ..... me shpallje puplike me nr. .... për shitje elektronike të pronës së detyruesit të falimentuar ..... nga ..... në falimentim për herë të parë.

-Me datën 21 mars të vitit 2012, në media është njoftuar se nga ana e Sektorit për punë të mbrendëshme ....., deri tek Prokuroria themelore, ishte parashtruar denoncim për vepër penale kundër 11 personave, për kryerjen e gjashtë veprave penale, me të cilat është dëmtuar shoqëria aksionare ,,.....,, .....

Denoncimi ishte parashtrua kundë drejtorit të mëparshëm gjeneral të kësaj shoqërie aksionare dhe kundër ndihmësve të tijë për punë juridike dhe financiare, si dhe kundër tetë personave tjerë antarë të këshillit të drejtorëve: të gjithë nga ....., për shkakë të dyshimit se kanë kryer veprën penale ,,Keqpërdorim autoriteti dhe pozitës zyrtare,,.

-Në seancën e Qeverisë së RMV-së, të mbajtur me datë 28.12.2019, si pikë e rendit të ditës ishte vendosur për shqyrtim – Kërkesë për shqiptim / pëlqim për përfundimin e procedurës së falimentimit kundër falimentuesit SHA....., me informacione shtesë. Në Procesverbalin e kësaj senace, në pikën 13 qëndron: ,,Qeveria e shqyrtone Informacionin për aplikimin e mjeteve juridike MBROJTJE DIPLOMATIKE, në lidhje me realizimin e aktakuzës me Aktëgjykim të plotëfuqishëm IV.TS. nr...../.... nga data 14.12.2010 në Gjykatën Themelore Shkupi 2 në Shkup u miratua kërkesa me këto konkluzione:

1. Detyrohet avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut në njësin \_\_\_\_\_, në rastin e falimentimit ...../..... i cili udhëhiqet në Gjykatën themelore të ..... debitorit të falimentuar ..... (në falimentim), ti parashtrojë propozim për shkarkimin e drejtuesit të falimentuar .....

2. Obligohet d-r ....., sekretar gjeneral i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, të realizoj bisedime për lidhjen e kontratës për investime në mjete juridike MBROJTJE DIPLOMATIKE drejtë Republikës së Sërbisë.

- Gjatë inspektimit të web faqes të Regjistrat Qendrorë të RMV-së, të realizuar me datë 22.06.2020 dhe 03.07.2020 nga ana e KSHPK-së është konstatuar se në evidencën e regjistrat Tregëtarë dhe regjistrin e personave tjerë juridik, nga lista e e falimentuesve aktivë, SHA ..... nga ..... është regjistruar si një subjekt në falimentim për të cilin procedurat e falimentimit është hapur me datën 21 dhjetorë të vitit 2016 para Gjykatës themelore të falimentimit në ..... dhe ka status aktivë për procedur të falimentimit të vazhdueshëm.

Në pajtueshmëri me me dispozitat e Ligjit për falimentim, derisa në procedurën e lëndës është sjellur një vendim për përfundimin e procedurës së falimentimit nga ana e gjyqtarit për falimentim është dashur të përcaktoj përfundim për procedurën e falimentimit dhe të regjistrohet në regjistrin e tregëtisë, në librat zyrtarë në të cilët shënohen të drejtat rrethë pronësisë dhe në regjistrat tjerë adekuat. Gjithashtu gjyqtari i falimentimit është i obliguar që të njoftojë se vendimi i sjellur për përfundimin e procedurës së falimentimit për të cilin do ti përmenden arsyet e mbylljes së procedurës, ajo nënkupton se është dashur patjetër në mënyrë të drejtpërdrejt të kryhet dorzim i këtij vendimit në shpallje publike në Gazetën Zyrtare të RMV-së si dhe dorzimi i të njëjt në organet të cilat e udhëheqin procedurat e regjistrimit, respektivisht në regjistrat zyrtarë, si dhe tek regjistrat ekonomike, respektivisht në regjistrat adekuat, që të kryhet regjistrimi adekuat.

-Drejtuesit e falimentimit në teritorin e RMV-së organizohen në Odën e drejtuesve të falimentimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila ka Statusë, kodeks, rregulla profesionale dhe akte tjera, kurse me Statusë të Odës së drejtuesve të falimentimit rregullohen organizimet, drejtimi, punën financiare dhe Odës si dhe kontrollin e mbrendëshëm.

-Këshilli i Odës së drejtuesve të falimentimit në përputhshmëri me nenin 290 paragrafi (1), alineja 3 nga Ligji për falimentim, kyen inspektim mbi punën e drejtuesve të falimentimit, kurse inspektim mbi mënyrën e autorizimit në Odën e falimentimit, kryen ministri i ekonomisë në detyrë. Në pajtueshmëri me nenin 293 paragrafi (7) nga po i njëjti Ligjë,, Personat e autorizuar për kryerjen e verpimeve të revizionit munden ti shqiptojnë drejtuesve të falimentimit dënim me qortim për shkelje të lehta për sjellje joshembullore dhe mundë të kërkojnë nga Oda ndryshimë të masave disiplinore për shqiptimin e të cilat ajo është kompetente. Kundër dënimit me qortim, dertuesi i falimentimit mund të paraqes ankesë deri tek Këshilli drejtues. Shqiptimi i dënimit me qortim, nuk ndikon në propoziminin për shqiptim të masës disiplinore. Nëse është ngritur masë disicplinore, dënimi i shqiptuar qortim nuk të derjtë veprimi,,

Në bazë të shqyrtimit të gjendjes faktike , Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit konstatonë se në rastin konkret bëhet fjalë për procedur të falimentimit e cila ishte e hapur mbi shoqatën aksionare më 21 dhjetorë 2016 me propozim të Ministrisë së finansave, Drejtorisë së të Ardhurave Publike në Drejtorisë Regjionale të Manastirit, propozim i cili ishte përvetësuar nga Regjistri qendrorë i RMV-së me Vednim i cili në evidentimet e regjistrit qendrorë udhëhiqet akoma si procedur aktive, që do të thotë se lënda e procedurës së falimentimit ishte akoma në procedur para organeve kompetente adekuate. Njëherit nësë parashtruesi e denoncimit janë të paknaqur me procedurën e udhëhequr të falimentimit dhe nga puna e drejtuesve të falimentimit të caktuar për të njëjtën, për atë kanë mundur të drejtohen deri tek organi adekuat kompetent, respekivisht, Këshilli Drejtues i Odeës së drejtuesve të falimentimit të cilat në pajtueshmëri me detyrat e tyre ligjore kryen inspektim mbi punën e drejtuesve të falimentimit.

Në bazë konstatimin, gjithashtu duke patur parasyhë se në rastin konkret kanë vepruar organe tjera kompetente të RMV-së , Komisioni Shtetërorë për parandalimin e korrupsionit vlerëson se nuk ka bazë për të vepruar me kompetencë në rastin në fjalë, denoncimi i parashtruar refuzohet, kurse lënda mbyllet, kurse parashtruesi i denoncimit të udhëzohet për tek organi zyrtarë kompetent për rastin në fjalë.

Duke iu referuar asaj që është përmendur më lartë, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit vendose në bazë të dispozitave të këtij vendimi.

### **E vesndosur me datën 11 dhjetorë të vitit 2020 me nr. 12 - 5579/ 2**

E parashtruar deri tek : Arkiva, Parashtruesi  
Me përfundim të KSHPK,  
Puno; J.C këshilltarë  
Miratoi : G.T.antar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПËР  
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT**  
Kyetar: Biljana Ivanovska